


Tregtia e jashtme e mallrave

Maj 2017

Tiranë, më 19 Qershor 2017: Në Maj 2017 eksportet e mallrave arritën vlerën 24 mld lekë, duke u rritur me 18,0 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 0,8 %, në krahasim me Prill 2017. Importet e mallrave në Maj 2017 arritën vlerën 55 mld lekë, duke u rritur me 5,8 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 9,7 %, në krahasim me Prill 2017. Deficiti tregtar i këtij muaji është 31 mld lekë, duke u ulur me 2,2 %, krahasuar me Maj 2016 dhe duke u rritur me 18,0 %, në krahasim me Prill 2017.

Fig. 1 Qarkullimi i mallrave, Maj 2015 – Maj 2017 (%)




Në pesë muajt e parë eksportet e mallrave arritën vlerën 111 mld lekë, duke u rritur me 16,7 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 238 mld lekë, duke u rritur me 4,6 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 127 mld lekë, duke u ulur me 4,1 %, krahasuar me 2016.

Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rritja vjetore e eksporteve prej 18,0 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: “materiale ndërtimi dhe metale” me +7,0 pikë përqindje, “ushqime, pije, duhan” me +4,2 pikë përqindje, “tekstile dhe këpucë” me +3,7 pikë përqindje.

Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Maj2017




Eksportet, gjatë pesë muajve të parë janë rritur me 16,7 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “materiale ndërtimi dhe metale” me +5,5 pikë përqindje, “minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +5,1 pikë përqindje, “tekstile dhe këpucë” me +3,5 pikë përqindje. Grupi që ka ndikuar negativisht në ndryshimin vjetor të eksporteve, është: “prodhime druri dhe letre” me -0,1 pikë përqindje.

Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rritja vjetore e importeve prej 5,8 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: “tekstile dhe këpucë” me +1,8 pikë përqindje, “ushqim, pije, duhan” me +1,4 pikë përqindje, “produkte kimike dhe plastike” me +1,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “materiale ndërtimi dhe metale” me -1,3 pikë përqindje.

Fig.3 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Maj2017



Importet, gjatë pesë muajve të parë, janë rritur me 4,6 % krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar në rritjen vjetore të importeve, janë: “produkte kimike dhe plastike” me +1,6 pikë përqindje, “tekstile dhe këpucë” me +1,2 pikë përqindje, “makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,0 pikë përqindje. Grupi që ka ndikuar negativisht në ndryshimin vjetor të importeve, është: “materiale ndërtimi dhe metale” me -1,5 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere

Në Maj 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Maj 2016 janë: Italia me (9,7 %), Kosova me (31,6 %) dhe Spanja me (247,9 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Greqia me (-4,0 %), Kina me (-28,5 %) dhe Bullgaria me (-9,7 %).


Gjatë pesë muajve të parë, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (9,6 %) Kosova me (24,8 %) dhe Spanja me (158,6 %).

Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Zvicra me (-39,1 %), Kroacia me (-45,8 %) dhe Danimarka me (-31,4 %).

Në muajin Maj 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Maj 2016 janë: Italia me (7,3 %), Turqia me (41,4 %) dhe Greqia me (16,2 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kina me (-9,3 %), Gjermania me (-36,3 %) dhe Spanja me (-21,3 %).

Në pesëmuajorin e parë, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (3,8 %), Turqia me (16,0 %) dhe Greqia me (7,5 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Gjermania me (-13,1 %), Kina me (-9,6 %) dhe Rusia me (-21,1 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Maj 2017



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 66,4 %. Në Maj 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,1 % dhe importet zënë 62,2 %. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (37,7 %), Greqia (6,8 %), Turqia (6,7 %) dhe Kina (6,3 %).

Shkëmbimet tregtare, për pesë muajt e parë, me vendet e BE zënë 65,7 %. Në periudhën Janar – Maj 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,5 % dhe importet zënë 60,7 %. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (37,6 %), Gjermania (7,0 %), Greqia (6,8 %) dhe Kina (6,4 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave (miliardë lekë)

Vitet	Muajt	Eksporte	Ndryshimi Vjetor	Importe	Ndryshimi Vjetor	Bilanci Tregtar	% e mbulimit
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-171	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-297	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-301	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2014	01 - 14	18	-1,4	35	2,2	-17	51,2
	02 - 14	20	27,9	39	17,5	-19	51,8
	03 - 14	21	10,4	42	11,1	-21	50,1
	04 - 14	23	10,3	44	6,8	-22	51,3
	05 - 14	25	9,1	48	6,9	-23	52,5
	Janar – Maj 2014	108	10,7	209	8,7	-102	51,4
2015	01 - 15	18	-0,6	35	0,9	-17	50,4
	02 - 15	18	-9,4	39	-0,8	-20	47,3
	03 - 15	22	4,1	44	4,6	-22	49,9
	04 - 15	21	-8,5	44	-1,4	-23	47,6
	05 - 15	24	-4,8	44	-8,0	-20	54,3
	Janar – Maj 2015	103	-4,0	207	-1,2	-103	49,9
2016	01 - 16	16	-7,8	35	-1,0	-18	47,0
	02 - 16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	03 - 16	19	-12,7	47	5,6	-28	41,2
	04 - 16	21	1,7	52	19,0	-31	40,7
	05 - 16	21	-14,8	52	16,7	-31	39,6
	Janar – Maj 2016	95	-8,0	227	10,1	-132	41,8
2017	01 - 17	19	15,5	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04 - 17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	05 - 17	24	18,0	55	5,8	-31	44,2
	Janar – Maj 2017	111	16,7	238	4,6	-127	46,6

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Maj-16	Maj-17	Jan.- Maj 2016	Jan.- Maj 2017	Maj-16	Maj-17	Jan.- Maj 2016	Jan.- Maj 2017
Vendet e BE-së	15.690	18.439	74.264	84.857	33.832	34.079	141.073	144.457
Austri	101	190	509	681	526	497	2.247	2.102
Mbretëri e Bashkuar	67	54	179	147	406	605	1.654	2.192
Gjermani	599	863	3.247	4.509	6.215	3.956	23.025	20.006
Greqi	1.107	1.063	4.364	4.924	3.736	4.343	17.617	18.930
Itali	11.767	12.905	55.011	60.303	15.758	16.915	68.156	70.742
Spanjë	324	1.126	2.061	5.331	1.541	1.212	4.788	4.955
Kroaci	369	94	566	307	278	307	1.517	1.516
Të tjera të BE-së	1.356	2.145	8.326	8.655	5.373	6.243	22.068	24.014
Kinë	515	368	1.847	4.206	5.046	4.575	20.067	18.136
Kosovë	1.510	1.987	6.513	8.127	583	800	2.123	3.113
Maqedonia	558	824	2.217	3.232	686	771	2.776	3.206
Rusi	45	5	46	37	636	691	4.764	3.757
SHBA	119	128	593	1.009	802	963	3.575	3.903
Turqi	96	167	458	815	3.630	5.133	17.398	20.176
Ukrainë	24	39	69	241	457	636	1.817	1.751
Zvicër	127	47	1.067	650	514	397	3.293	3.240
Të tjera	1.843	2.217	7.919	7.712	5.619	6.775	30.555	36.156
Gjithsej	20.526	24.221	94.994	110.884	51.805	54.819	227.441	237.895

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Maj-16	Maj-17	Jan.- Maj 2016	Jan.- Maj 2017	Maj-16	Maj-17	Jan.- Maj 2016	Jan.- Maj 2017
Gjithsej	20.526	24.221	94.994	110.884	51.805	54.819	227.441	237.895
Ushqime, pije, duhan	2.659	3.530	9.539	10.984	8.434	9.141	39.284	41.019
Minerale, lëndë djegëse, en.et.	3.069	3.192	15.277	20.086	3.848	3.971	19.085	20.501
Produkte kimike dhe plastike	349	448	1.730	1.886	7.237	7.873	32.004	35.568
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	221	359	1.197	1.226	1.935	2.217	7.016	7.610
Prodhime druri dhe letre	665	683	3.182	3.073	1.876	2.225	8.841	8.986
Tekstile dhe këpucë	9.236	10.005	44.289	47.618	7.611	8.537	32.083	34.767
Materiale ndërtimi dhe metale	2.599	4.027	12.318	17.508	8.195	7.497	33.661	30.225
Makinëri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1.116	1.300	4.671	5.689	10.453	10.904	47.472	49.703
Të tjera	612	679	2.792	2.815	2.214	2.454	7.995	9.518

Tab. 4 Eksportet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, (Jan.- Maj 2016, Jan.-Maj 2017)

(milionë lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Greqi	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
Gjithsej	55.011	60.303	6.513	8.127	2.061	5.331	4.364	4.924
Ushqim, pije duhan	2.892	2.639	1.096	1.152	322	361	866	732
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	2.576	4.512	1.266	2.438	617	4.079	192	138
Produkte kimike dhe plastike	569	565	552	533	0	2	136	229
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.079	952	0	2	3	10	23	29
Prodhime druri dhe letre	2.421	2.184	114	137	2	3	343	426
Tekstile dhe këpucë	35.987	37.633	25	55	795	688	1.896	2.170
Materiale ndërtimi dhe metale	5.126	6.905	2.708	3.128	294	182	731	693
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	3.111	3.522	270	258	22	1	32	342
Të tjera	1.249	1.391	483	422	7	5	145	165

Tab. 5 Importet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, (Jan.- Maj 2016, Jan.-Maj 2017)

(milionë lekë)

	Itali		Turqi		Gjermani		Greqi	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
Gjithsej	68.156	70.742	17.398	20.176	23.025	20.006	17.617	18.930
Ushqim, pije duhan	6.901	7.260	2.137	2.411	1.668	1.572	6.075	5.531
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	7.327	6.387	303	939	235	243	1.392	2.303
Produkte kimike dhe plastike	6.695	7.622	2.473	3.089	2.469	3.116	3.041	3.299
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	5.596	5.880	143	151	2	4	50	29
Prodhime druri dhe letre	2.587	2.542	1.119	1.315	325	311	991	1.105
Tekstile dhe këpucë	16.698	17.551	5.743	6.272	1.037	1.000	1.480	1.530
Materiale ndërtimi dhe metale	6.972	8.085	2.042	2.202	7.781	2.760	2.818	3.444
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	13.200	12.981	2.621	2.873	8.934	10.219	1.151	964
Të tjera	2.181	2.435	816	925	574	781	621	727

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

÷ deri